

## NJË VËSHTRIM MBI KRIJIMTARINË LETRARE TË ILO MITKË QAFËZEZIT

**PROF. AS. DR. JONELA SPAHO**  
Fakulteteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Universiteti, “Fan S. Noli” Korçë  
[jspaho@gmail.com](mailto:jspaho@gmail.com)

**Abstrakt:** *Ilo Mitkë Qafëzezi është një personalitet i çmuar i kulturës shqiptare, i cili ka dhënë kontributin e tij të vyer në disa fusha të rëndësishme të kësaj kulture, sidomos ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Vepra e tij e botuar, por edhe dorëshkrimet që presin dritën e studimit dhe botimit të tyre, janë të një rëndësie të dorës së parë për historianët, gjuhëtarët, shkrimtarët, por edhe më gjerë dhe paraqet interes për të hedhur dritë mbi aspekte ende të pastudiuara sa duhet të historisë dhe kulturës kombëtare.*

*Ky punim hedh një vështrim të përmbledhur mbi krijimtarinë e Ilo Mitkë Qafëzezit si komedian, mbledhës, por edhe krijues i anekdotave popullore e shkrimtar për fëmijë. Kjo krijimtari ka rolin dhe meritën e vet në kuadrin e zhvillimeve të letërsisë shqipe, sidomos të kohës kur i përkasin, pasi rezultojnë si ndër të parat vepra të zhanrit në të cilin janë shkruar. Megjithëse e pakët kjo krijimtari, si dhe pjesa tjetër që mbetet në dorëshkrim, duhet të studiohet e analizohet, për të përcaktuar drejt rolin e autorit në proceset e zhvillimit të letërsisë shqipe si dhe për ta pasuruar këtë letërsi me vepra që luajtën rolin e tyre të rëndësishëm dhe emancipues në kohën kur u shkruan*

**Fjalë kyçe:** *kulturë, identitet, komedian, folklorist, shkrimtar, studiues*

### A VIEW ON THE LITERARY CREATIVITY OF ILO MITKË QAFËZEZI

**Abstract:** *Ilo Mitkë Qafëzezi is an important personality of Albanian culture, who has given his important contribution in several important areas of this culture, especially those related to national identity. His published work, but also the manuscripts that look forward to the day of their study and publication, are of paramount importance to historians, linguists, writers, and beyond, and it is of interest to shed light on still unstudied aspects of national history and culture.*

*This work gives a brief overview of the creativity of Ilo Mitkë Qafëzezi as a comedian, collector, but also creator of popular anecdotes, as well as a writer for children. This creativity has its role and merit in the context of the developments of Albanian literature, especially of the time when they belong,*

*as they result as among the first works of the genre in which they are written. Although few, this creativity, as well as the rest that remains in the manuscript, should be studied and analyzed, to correctly define the role of the author in the development processes of Albanian literature and to enrich this literature with works that played their role. important and emancipatory at the time it was written.*

**Keywords:** *culture, identity, comedian, folklorist, writer, studies*

Ilo Mitkë Qafëzezi është një personalitet i çmuar i kulturës shqiptare, i cili ka dhënë kontributin e tij të vyer në disa fusha të rëndësishme të kësaj kulture, sidomos ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Vepra e tij e botuar, por edhe dorëshkrimet që presin ditën e studimit dhe botimit të tyre, janë të një rëndësie të dorës së parë për historianët, gjuhëtarët, shkrimtarët, por edhe më gjerë dhe paraqet interes për të hedhur dritë mbi aspekte ende të pastudiuara sa duhet të historisë dhe kulturës kombëtare.

Lindi në Korçë, në vitin 1889, por prejardhja e familjes së tij ishte nga Qafëzezi i Kolonjës. Kur ishte 13 vjeç, shkoi në Rumani dhe më pas emigroi në Amerikë ku qëndroi deri në vitin 1924. Në Amerikë, ku krahas punës vazhdonte edhe shkollën, ra në kontakt për herë të parë me shkrime të ndryshme që flisnin për figura të njohura e luftëtarë trimë të Shqipërisë. I tërhequr nga personaliteti kompleks i disa figurave historike, ai zgjodhi të përkthente në shqip “Historia e Ali Pashë Tepelenës” të Arvantinoit. Përkthimin e pasuroi dhe e ilustroi edhe me këngë popullore që këndoheshin për pashain famëmadh.

Vazhdimisht lexonte, grumbullonte material, përkthente në shqip dhe botonte. Në një kohë shumë të shkurtër botoi “Historia e Napoleon Bonapartit”, “Qysh u gjend Amerika”, “Kurani shqip”, “Këndime” etj. Më pas, u kthye përfundimisht në Korçë dhe punoi si mësues e drejtor shkolle. Edhe puna e tij krijuese, tashmë, mori një drejtim tjetër, kryesisht, si punë e mirëfilltë gjurmuese e studimore për fakte e të dhëna me karakter historik e gjuhësor, sidomos për Korçën, Voskopojën, Vithkuqin, Beratit etj, që ishin qendra të zhvilluara në shekullin XVIII; si dhe për njerëzit e figurat e shquara të asaj kohe. Tani ai ishte i pajisur me një kulturë të gjerë, si njohës i disa gjuhë të huaja të Ballkanit dhe të Evropës dhe kishte përgatitjen e duhur për të vlerësuar dhe interpretuar veprat historike e gjuhësore të figurave të njohura të këtyre qendrave. I ndikuar, siç pohon edhe vetë, nga mësuesi

i tij i parë Nuçi Naçi, më pas nga rrethet patriotike të kolonive shqiptare të emigracionit që i mëkuan atdashedashurinë, si dhe i fymëzuar nga poeti ynë i madh Asdreni, ai iu përkushtua gjithë jetën studimeve të dokumenteve që evidentonin kulturën dhe identitetin shqiptar. Këto ndikime do të bëheshin faktorë të fuqishëm që ai t'ia dedikonte jetën leximit dhe mësimin duke shfletuar gazeta, revista e libra të ndryshëm, në mënyrë autodidakte si dhe të mblidhte e të grumbullonte gjithçka që i binte në dorë për Shqipërinë dhe për historinë e popullit shqiptar. Gjithashtu, ai kishte një pasion të jashtëzakonshëm për mbledhjen e krijimtarisë artistike popullore, këngët, tregimet, përrallat e legendat dhe sidomos humori që shpalosej në to.

Me një punë këmbëngulëse e sistematike, ai zbuloi në manastirin e Shën Pjetrit, në Vithkuq dhe në kishat e Voskopojës, një dorëshkrim të Theodhor Kavaliotit dhe një dorëshkrim shqip të Dhaskal Kostë Vithkuqarit. Po kështu, zbuloi edhe një kopje të botimit të parë të fjalorit katërgjuhësh të Dhanilit, botuar në Venedik, në vitin 1794. Në këto kisha ai zbuloi edhe abetaren e Naum Veqilharxhit të vitit 1844. Por puna e tij nuk u mjaftua me kaq. Këto zbulime e fakte të reja, shumica e tyre të panjohura deri atëherë, i bëri të ditura duke i botuar në organe të ndryshme të shtypit që dilnin në atë periudhë, si në Korçë, ashtu dhe në qytete të tjera. Ilo Mitkë Qafëzezi pati bashkëpunim të përhershëm me “Gazetën e Korçës”, “Hylli i dritës”, revistat “Leka”, “Minerva” etj. Ai botoi një sërë shkrimesh dhe qe i pari që solli fakte e botoi dokumente me shumë interes për zhvillimin ekonomik, politik e kulturor të trevës së Voskopojës, Korçës, Vithkuqit, Beratit etj, si dhe shkaqet që çuan në prishjen e shkatërrimin e tyre. Ilo Mitkë Qafëzezin në punën e tij e kanë tërhequr tepër edhe traditat, zakonet e vjetra, bile edhe lodrat e fëmijëve të vegjël. Studimi i tij “Zhvillimi i lodrave të kalamanit shqiptar” u përdor nga profesori rumun Theodhor Kapidani në veprën e tij “Lodrat me ashikë tek fëmijët e Ballkanit”.

Ilo Mitkë Qafëzezi, si njohës i thellë i historisë së Voskopojës dhe i jetës e veprave të Theodhor Kavaliotit, ishte i pari që shkroi një monografi me vlerë për të. Kjo monografi që titullohet “Protopapa Theodhor Nastas Kavalioti Voskopojari, Shkollarku i Akademisë së Re të Voskopojës”, është një sintezë e 15 artikujve dhe studimeve speciale botuar nga autori gjatë periudhës 1934-1943, në revistat kulturore “Jeta”, “Minerva” etj. Po kështu, dorëshkrim i pabotuar ka mbetur edhe

një monografi e gjatë për Korçën.(Bitraku A, I.M.Qafëzezi një thesar ende i pazbuluar i kultures, 2011)

Siç shihet, Ilo Mitkë Qafëzezi, megjithëse autodidakt, ka bërë një punë të madhe e voluminoze, duke sjellë një kontribut të shquar në mjaft fusha të veprimtarisë letrare e shkencore. Ai ishte i pajisur me një kulturë të gjerë dhe biblioteka e tij ishte shumë e pasur. Më 1946, ai humbi krejtësisht dritën e syve nga një sëmundje e gjatë dhe e rëndë. Megjithatë, vullneti e këmbëngulja e tij ishin për t'u admiruar. Ilo Mitkë Qafëzezi vdiq në Korçë, në vitin 1964, duke lënë pas emrin e mirë dhe shumë botime në fushën e letërsisë dhe kulturës sonë kombëtare.

Në kompleksitetin e personalitetit kulturor të I.M.Qafëzezit, nuk mund të anashkalohet një aspekt i rëndësishëm siç është krijimtaria letrare artistike, që na servir vepra e tij. Parë dhe studiuar në këtë aspekt, krijimi artistik i tij rrok tri aspekte: atë të komediografit, të folkloristit dhe të shkrimtarit për fëmijë.

Vështruar përmes këtyre aspekteve, I.M.Qafëzezi meriton vëmendjen e studimeve letrare në këto lloje, aq pak të lëvruara në kohën kur ai i shkroi. Nisur nga konteksti kohor i tanishëm, kjo krijimtari nuk ofron sasi dhe ka pika të diskutueshme. Nisur nga klima kulturore dhe letrare e kohës kur u shkruan dhe u botuan, ato sjellin një ndihmesë jo pak të konsiderueshme. Pa pretendimin e një studimi të thelluar kritikoletrar, ky shkrim rreket të krijojë imazhin e profilit letrar të I.M.Qafëzezit dhe rëndësinë e pozicionit që zë vepra e tij, sipas zhanrit të lëvruar në historinë e letërsisë shqipe. Kështu, nëse i referohemi krijimtarisë letrare të tij, padyshim që së pari do të ndalemi te komediografi, më pas te folkloristi dhe së fundi te shkrimtari për fëmijë. E cilësojmë së pari si komediograf duke iu referuar veprës më të rëndësishme letrare, jo vetëm për materialin që sjell, por dhe për lëvrimin e një prej gjinive aq të rralla, por shumë të mirëpritura dhe të dëshiruara nga publiku i kohës dhe skenat e teatrove amatore “Dhaskal Gjoka, apo shkolla korçare e qëmoçme”, botuar në Korçë, në vitin 1936, me një kushtim tepër prekës në ballinë të saj: *“I kushtohet hijes së adhuruar të mësonjësit t’em të ndjermë, që më frymëzoi shumë dashuri për shqipe dhe për Shqipëri”* (Qafëzezi, I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936). Kjo komedi, në kontekstin kohor dhe letrar, i përket gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fazës së dytë të zhvillimit të komedisë tek ne. Komedia, si një lloj relativisht i vështirë i gjinisë dramatike në letërsinë tonë të traditës, ka

njohur një zhvillim të vonët dhe të pakët në sasi. Nëse i referohemi zhvillimit të komedisë në letërsinë tonë, fillesat e saj i gjejmë në periudhën e fundit të Rilindjes. Zhvillimi i dramaturgjisë gjatë kësaj periudhe dha frytet e veta dhe në llojin komik. Prof. Kudret Velça, në studimin e tij për historinë e teatrit shqiptar të viteve 1912-1939, vë në dukje mbizotërimin e komedisë. (Velça, K., Historia e teatrit shqiptar I, Tiranë, 1984, f. 118.110). Ky fakt do të shpjegohej me disa përparësi që ka ky lloj i gjinisë dramatike. Në fakt, komedia është cilësuar si kompensim filozofik, po aq sa dhe psikologjik. Sa herë që ne bëhemi të ndërgjegjshëm, se kjo nuk është bota më e mirë e mundshme, na duhet ndihma e komedianeve për të përballuar “defektet” e pakapërcyeshme të realitetit. Vizioni i lartë komik i jetës është humori, një arritje kjo e njeriut si qenie njerëzore, Meredith këtë kishte parasysh kur thoshte se komedia është civilizuesi ynë përfundimtar. (Meredith, G., An essay on comedy, Nju-Jork, 1956, f. 47.)

Fillimet e saj i gjejmë në fazën e fundit të letërsisë së Rilindjes me dy komedi të mirënjohura të Çajupit dhe një komedi të Gramenos, të cilat u krijuan në kohën kur në jetën e trazuar shqiptare, krahas problemeve politike u bënë evidente dhe problemet shoqërore. Këto komedi krijuan një traditë, e cila u zhvillua më pas në periudhën e viteve 1912-1939, përmes dy fazave.

Faza e dytë e zhvillimit të komedisë në këtë periudhë, në të cilën përfshihet dhe vepra në fjalë, u prir më tepër, pohojnë studiuesit, drejt efektit argëtues të zhanrit, më shumë sesa u mundua të ngrinte probleme. Por, është i vërtetë fakti, që krahas ndonjë komedie zbavitëse, siç ishin ato të Aleko Vançit apo Dhori Kotit, pati dhe komedi që prekën probleme të rëndësishme. “Dhaskal Gjoka” është pikërisht një komedi e tillë, e cila përpos elementëve ekspresivë të humorit dhe të së qeshurës, ka dhe karakter të theksuar pedagogjikodidaktik, që shtron një problem të rëndësishëm siç është ai i përdorimit të metodave të vjetra pedagogjike në shkollën fillore. Kjo komedi, përmes humorit që varion nga një ironi e hollë në satirë dhe sarkazmë, duke arritur dhe në grotesk, trajton dhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës shqipe, përveç asaj greke, me afirmimin e idealeve atdhetare e deri në problemet që kanë të bëjnë më çështjet e etikës dhe moralit. Gama informative e komedisë, në këtë aspekt meriton vëmendje.

Autori e pohon këtë në parathënien e veprës: *“Mundem të them se këto pjesëra sjellin ca më tepër dobi se librat edhe sesa konferencat. Pjesa teatrore dramatike, veçanërisht komedia është hem e këndëshme, hem instruktive, si për ata me gramë si për ata që nuk kanë dituri.”*, (Qafëzezi I. , Dhaskal Gjoka, Korçë,1936), pohim ky që dëshmon qëllimin e një vepre të shkruar për të gjithë dhe të receiptueshme gjerësisht. Për të realizuar një komedi të tillë, autori është përpjekur të fokusohet tek karakteri komik, i cili është ndërtuar përmes kontradiktave dhe situatave komike, gjatë të cilave veprimet dhe arsyetimet e dhaskalit spikasin thelbin grotesk të tij. Lëvrimi i komedisë, si lloj i gjinisë dramatike, është shprehje e zhvillimit dhe emancipimit shoqëror, e forcimit të vetëdijes kritike të një shoqërie që synon të integrohet në proceset moderne të jetës së saj. Dihet se zhvillimi i komedisë, sidomos karakteri kritik i saj, fshikullues ndaj dukurive negative të shoqërisë, mund të bëhet kur ekziston një farë lirie e mendimit kritik. Aristoteli te vepra e tij *“Poetika”*, shkruan se komedia është imitimi i çdo gjëje më të keqe nga ç’është në realitet dhe imiton ato vese që janë qesharake. Sipas tij, nëse tragjedia synon të pasqyrojë njerëzit më të mirë se ç’janë në të vërtetë, komedia i pasqyron njerëzit jo në tërë format, por vetëm në formën e tyre qesharake. (Aristoteli, *Poetika*, Tiranë, 2004, f. 20).

Dukuritë komike lindin prej shkaqeve të ndryshme. Disa dukuri të vjetëruara që përpigën të paraqiten si bashkëkohore janë, shpesh, shkak primar i komikes. Por, komikja lind dhe kur përfaqësues të shtresave të caktuara shoqërore mendojnë se luajnë një rol të rëndësishëm shoqëror, ndërkohë që roli i tyre është regresiv dhe qesharak. Këta individë që ndjekin automatikisht fatin e tyre, pa menduar për lidhjet me të tjerët janë shpesh burimi i komizmit. I tillë është dhe dhaskal Gjoka, i cili mendon se e drejta e tij për të dhënë mësim është e pazëvendësueshme dhe roli i tij është i pamohueshëm, ndërkohë që misioni i tij, në fakt, ka marrë fund dhe metodave të tij u ka kaluar koha. I ndërtuar përmes kësaj kontradikte, midis metodave të tij të vjetëruara pedagogjike dhe fanatizmit me të cilin i mbron, ky karakter është i realizuar plotësisht brenda kuadrit komik, nëpërmjet kombinimit të së qeshurës, por dhe keqardhjes për fatin e dhaskal Gjokës.

Aristofani thotë se heroi tragjik nuk mund të jetë dhe i korruptuar, ose dhe thjesht një viktimë e fatit të keq, ndërsa komedia kënaqet të ketë të bëjë me ata që janë viktima të fatit të keq, së bashku me ata që janë të

korruptuar e plot vese dhe i paraqet ata me anë të satirës dhe groteskut. Dhaskal Gjoka është tipi i mësuesit pedant e i dhunshëm, i cili në mënyrë strikte aplikon metoda të vjetëruara e kthehet në një bunker përballë sugjerimeve për të ndryshuar. Ai vetëdemaskohet duke gjeneruar komizëm, nëpërmjet të menduarit dhe të vepruarit në situata të veçanta, siç janë ato të etiketimit vulgar të nxënësve për fjalët e shqiptuara gabim, ndëshkimet viktoriane të fëmijve, mënyrat sesi kërkon të përfitojë materialisht prej prindërve që dërgojnë fëmijët në shkollë, mënyrës qesharake se si reagon ndaj thashethemeve që qarkullojnë rreth tij, etj.

Karakterin komik autori e realizon gjithashtu nëpërmjet alogjizmit. Gjatë gjithë zhvillimit të komedisë vërehet aktivizimi i alogjizmit, si një mjet i fuqishëm stilistik për të thelluar kontradiktën komike, duke zbuluar nëpërmjet tij shterpësinë mendore të personazhit, çka vë në lëvizje mekanizmin komik të situatave. Kështu, dhaskal Gjoka është alogjik në gjithë konceptimin e sistemit të tij pedagogjik, të cilin e mbështet në parimin se “druri është derë e paradhisit” dhe se nëpërmjet tij mund të “shërojë veset”. Alogjizmi me të cilin ai mbështet teorinë e tij të vlerave, e kthen atë në një karikaturë groteske e të zvetënuar, që nuk merr fare parasysh dëshirat dhe shpalosjen e lirë të lirisë së fëmijës, çka Rusoi e kishte propoganduar me forcë një shekull më parë. Kulmin alogjizmi i tij e arrin kur kërkon të disiplinojë në mënyrë strikte dhe nevojat fiziologjike të fëmijëve. Sistemi i tij pedagogjik del si një farsë qesharake kur protoskollli i tij 13- vjeçar i thotë: *“Nga të gjitha këto që këndoj as fare nuk marr vesh. Mua më k’ënda të rrynj brenda në këto fjalë të perëndisë. Të këndosh dhe gjë të mos kuptosh, gramë i thonë kësaj? Katran me bojë.”* (Qafëzezi I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936), Ndërsa përgjigjja alogjike dhe qesharake e dhaskalit, tipizon përfundimisht karakterin komik të tij: *“Dale morre Nuçi biro. Ti dashke të rrynj brenda e të dish dhe ato që nuk i dinë dot vetë priftërinjtë!”* (Qafëzezi, I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936), Ja pra, ky është kulmi grotesk i dhaskal Gjokës, i cili nuk ka ideale etike dhe pedagogjike dhe mbron me forcë të drejtat e tij.

Në këtë mënyrë, realizimi i unitetit mes karakterit dhe veprimit na çon natyrshëm drej thelbit të tij. Nisur nga sa theksuam, subjekti i komedisë nuk karakterizohet nga një veprim i gjatë dhe ndeshje personazhesh, por për ta bërë veprën interesante autori rrit komizmin gradualisht, komizëm i cili arrin kulmin në fund të komedisë, kur interesat e

dhaskalit vihen në diskutim. Autori di ta vërë situatën në funksion të realizimit të karakterit komik, në mënyrë të natyrshme dhe spontane, sepse kjo është dhe natyra e komedisë, e cila ndryshe nga tragjedia s'ka nevojë ta ruajë veten me anë të ndonjë logjike të pashmangshme, apo me anë të rregullave akademikë. Ajo i bën artistike të gjitha rastet që propabiliteti tragjik mundohet t'i mënjanojë. Kjo na lejon të shpjegojmë dhe justifikojmë shumë aspekte të kësaj komedie, e cila po t'u referoheshim kërkesave specifike të zhanrit, do të linte shumë për të dëshiruar.

Duke qenë se subjektet e veprave komike mund të jenë të ngjashme me materialin që nxjerr jeta, dalim në përfundimin se autori është përpjekur të zgjedhë një subjekt, që edhe pse për kohën kur u shkrua nuk ishte shumë aktual, prapë sjellë skena jetësore që janë të lidhura drejtpërdrejt me mentalitetet e jetesës, sidomos në qytetin e Korçës. Ajo paraqet skena të këndshme që të bëjnë të shkrihesh gazit, por të vënë dhe në mendime, sepse reminishenca të dhaskal Gjokës mund t'i gjesh në çdo kohë, sepse në komedi ne qeshim me vesin, por dhe frikësohemi me dyshimet tona për gjëra që ndoshta s'do të ndodhin kurrë. Në këtë mënyrë komedia si shenjë e zhvillimit dhe emancipimit shoqëror realizon atë "katharsis" aq të rëndësishëm, që e bën atë të receptueshme dhe të pëlqyeshme, ashtu siç u bë dhe komedia në fjalë. Interes paraqesin në komedi dhe personazhet e tjerë, dy prej të cilëve janë dhe personazhe historike: Naum Veqilharxhi dhe Kostë Mitkua. Ata, përpos rolit që luajnë në zhvillimin e subjektit dhe organizimin e dialogëve, janë dhe zëdhënës të ideve të autorit në lidhje me shtjellimin e pikëpamjeve të tij pedagogjike dhe patriotike.

Për sa i përket mënyrës së ndërtimit, ashtu si dhe komeditë e tjera të periudhës dhe tek kjo vepër vërehet ndikimi i komedisë klasiciste, me respektimin e njësisë së kohës, vendit dhe veprimit, trajtimit të problemeve etike, madje ndikimi vërehet dhe në mënyrën e ndërtimit të ndonjë personazhi. Të bën përshtypje, veçanërisht, përshtypje të saktë i veshjes dhe ambientit, çka thekson dëshirën dhe qëllimin e autorit për receptimin e saj nëpërmjet skenës.

Pa lënë mënjëanë këtë kontribut të autorit në fushën e komedisë dhe duke iu referuar përsëri sferës së satirës dhe humorit, nuk mund të mos vlerësojmë dhe përmbledhjen me tregime në vargje "Rrësku arbëror: (Hazna Shqipëtare): tregonjësja popullore satirike për të mëkur së qeshuri ndër vjersha", i cili u shkrua me alfabetin e Stambollit dhe u



botua për herë të parë në Selanik në vitin 1910 dhe më pas u botua përsëri në Korçë, në vitin 1924. Ishte vetëm 16 vjeç kur botoi në Rumani “Anekdota shqiptare”, që nuk kaluan pa rënë në sy të mjaft lexuesve e studiuesve. Edhe kur ishte në Amerikë, megjithëse punëtor fabrike, nuk reshti së mbledhuri material folklorik nga goja e popullit, e shqiptarëve që punonin e jetonin atje.

Në këtë vëllim, autori me një humor të hollë, përpunoi në vargje rrëfenjëzat e bukura të mbledhura me kujdes nga goja e popullit. Aty ironizohen, vihen në lojë e fshikullohen kadilerët, pashallarët, bejlerët, hoxhallarët e priftërinjtë që gënjenin e mashtronin popullin. Gaetano Pettrota thekson se kjo figuron si e vetmja vepër anekdotash satirike shqip në historinë e letërsisë sonë. (Pettrota, G., *Popolo lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931.)

Në historinë e folkloristikës shqiptare shpesh është përmendur puna kolosale e Mitkos, Jubanit, Dines etj., në mbledhjen e folklorit, por tepër rrallë është përmendur emri i I.M. Qafëzezi, i cili jo vetëm mblodhi dhe grumbulloi, por dhe përshtati në vargje rreth 73 anekdota satirike, të mbledhura nga goja e “llauzit shqiptar”. E veçanta e kësaj përmbledhjeje qëndron në faktin se I. M. Qafëzezi ishte vetëm 15 vjeç kur i mblodhi e i përpunoi dhe 19 vjeç kur i botoi. Siç e thamë, janë rreth 73 anekdota satirike në vargje të metrave e gjatësive të ndryshme, gjithmonë të rimuara sipas skemës AA BB ose ABAB, ndërsa vargjet variojnë që nga 8-rrrokëshi i poezisë popullore e deri te 16-rrrokëshi. Anekdotat shquhen për larmi tematike dhe siç i klasifikon vetë autori, në një shkrim polemizues në “Gazetën e Korçës”, gjysma e tyre merren me veset dhe gabimet e njerëzve të pasur, në hirearkinë e të cilëve përfshihen mbretër, vezirë, pashallarë, gjykatës, priftërinj dhe hoxhallarë, madje dhe ndonjë figurë historike si ajo e Ali Pashë Tepelenës, ndërsa pjesa tjetër e tyre i përkasin Hoxhë Nastradinit “të madhit ironist filozof”. Por, në këtë përmbledhje, përveç materialit të mbledhur në popull e të mësuara prej babait të tij zdrukthëtar, një pjesë e anekdotave janë krijime origjinale të autorit, madje dhe kur e braktisi këtë lloj krijimtari ai vazhdonte të kishte rreth 100 copëza të tilla ende të papërpunuara. Autori pretendon në autenticitetin e këtyre anekdotave, duke theksuar se ato janë pasuri popullore dhe vetëm përpunimi artistik është meritë e tij. Ato janë bërthama anekdotash që bëjnë pjesë në folklorin e pashtershëm shqiptar: “*Janë thërrime anekdotash llauzishte të treguara në Toskëri*” (Qafëzezi, I., Rrësku

arbëror, Korçë, 1924). Vlera e tyre spikat dhe qëllimin e autorit, i cili nga njëra anë, përmes satirës dhe humorit, rreket të përqeshë dhe thumbojë veset, dobësitë dhe anët negative të jetës njerëzore, me një vello të imët filozofie tipike popullore, në mënyrë që njerëzit nëpërmjet tyre të shohin më qartë vetveten, duke qeshur dhe zbavitur, dhe nga ana tjetër “ato të ndihmojnë të ndreqësh ndonjë kusur që ndofta do të bëhet huq, që të mos katandisesh të qeshin të tjerët me ty si me ata të shakasë”. (Qafëzezi, I., Rrësku arbëror, Korçë, 1924).

Përmes tyrë shpaloset një galeri e tërë tipash qesharakë, të cilët bien pre ose e padijes, ose e lakmisë dhe egoizmit të tyre. Ndër më të bukurat, ku morali gjen vend për t’u ndërthurur natyrshëm me filozofinë janë: “Ali pashë Tepalena dhe prifti i Hormovës”, “Prifti dhe kusarët”, “Jam turk për zotnë Krisht”, “Mjekra e kadiut”, “Prej asaj bote”, “Vleftë e rrobes së rë”, “Nastradini në gosti”, “I verbëri” etj.

Në përgjithësi, autori nuk e bën moralin qëllim në vetvete por, përmes rrëfimit të ngjarjes i jep mundësi lexuesit të nxjerrë përfundimin. Duke qenë anektoda të mbledhura në popull, autori zbulon në to thesare mençurie e filozofie të “...shqipos së varfër malësor dhe fusharak, i cili me gjithë mbijetesën e gjatë të paditurisë si njeri i ngurtë dhe i shtypur ndë zgjedhën turke e nën influencë polesh e kulturash të huaja, ka mundur të na e ruajë të pacënuar këngën popullore, përrallën dhe shakanë. Ndë mest të frazave të shakave të vatrës kemi për të zbuluar me qindra e mijra fjalë shqipe të paregjistruara ndë ndonjë fjalor shqip nga ato që kemi gjer më sot. Anektodat përbëjnë një pjesë të krijimtarisë gojore poulllore dhe të kulturës sonë të cilat nuk duhen nënvleftësuar”. (Qafëzezi I., Rrësku arbëror, Korçë, 1924).

Parë në këto aspekte, I.M. Qafëzezi është ndër të parët folkloristë që janë marrë më mbledhjen dhe përpunimin e anekdotave satirike. Megjithëse në ndonjë shkrim, në shtypin e kohës kur jetoi autori, janë shprehur mendime nënvleftësuese për këto pjesë, përsëri ato kanë vlerë dhe rëndësi, së pari si fond i trashëgimisë kulturore dhe së dyti për mesazhet universale që ato mbartin, pavrësisht formës së thjeshtë e pa pretendime të dukshme letrare që ka arritur t’u japë autori.

Së fundi dhe shkurtazi nuk mund të mos përmendim krijimtarinë e tij në fushën e letërsisë për fëmijë, gjë e cila merr rëndësi duke e pozicionuar në kontekstin kohor të viteve 30’, kur kjo letërsi kishte nevojë që të krijohet si degë më vete e letërsisë në përgjithësi. Shkrimet e tij për fëmijë ai i botoi kryesisht te revista “Vatra e Rinisë” e Vangjel

Xhaçkës dhe të “Gazeta e Korçës”, në një hark kohor që përfshin vitet 1933-1936, vite në të cilat ai kishte arritur pjekurinë letrare, siç ka ndodhur shpesh me të gjithë autorët që kanë shkruar për fëmijë, pasi kanë arritur kulmin letrar, sepse kjo lloj letërsie paraqet vështirësi relative që lidhen me të kuptuarit e botës dhe psikologjisë feminare.

Një ndër autorët që u shquan te revista “Vatra e rinisë” për krijimtari origjinale për fëmijë qe Ilo Mitkë Qafëzezi. Përmendim sidomos dy tregime dhe e dy përralla interesante të botuara aty. Në tregimin “Është kafshë shtëpiake”, jepet ideja e respektit ndaj punës në sfondin e jetës së shkollës, kurse te “Dhori Nazetori” vihen në lojë tekat e fëmijëve.

Përrallat janë: “Tre kurridalë të këqij”, “Kokodaku, kocomiu dhe ndrikulla Pambuke”. Në to dënohet tradhëtia e pabesia, himnizohet fuqia e njerëzve të thjeshtë të popullit. Te shkrimet e këtij autori vlen të përmendet veçanërisht prirja e tij humoristike që është një karakteristikë e domosdoshme për ata që ja kushtojnë veten letërsisë për fëmijë. (Bishqemi A, Historia e letërsisë shpise për fëmijë, Elbasan, 2000).

Ndër këto shkrime pra kemi dy lloj zhanresh të lëvruara prej tij, tregimet: “Dhori nazetari”, “Është kafshë shtëpiake”, “Ortaku i panginjur“, etj. dhe zhanrrin e përrallës : “Tre kurrisdalë të këqinj”, “Pse s’ka Baliku shtëpi”, “I shkreti lepur”, “Çafkëlorja dhe shtërgu “etj.. Për sa iu përket përrallave, ato paraqesin interes nëpërmjet elementëve që mbartin, duke marrë shpesh dhe trajtën e gojdhënave siç ndodh te “Çafkëlorja dhe shtërgu”, ku nëpërmjet një gjuhe të këndëshme dhe humorit, ai iu tregon fëmijëve se pse çafkëlorja ka mbetur “pa qafëzë”.

I. M. Qafëzezi është cilësuar si një ndër shkrimtarët që bën pjesë në letërsinë moderne shqiptare për fëmijë të viteve 30’, së bashku me M.S.Gurrën, V. Xhaçkën, Migjenin, T. Gjylin dhe Q. Guranjakun, madje është cilësuar së bashku me tre të fundit si një ndër shkrimtarët që njihen mirë botën e brendshme dhe dëshirat e fëmijëve. Këto lloj krijimtarie, padyshim, e ka favorizuar dhe profesioni i tij si mësues. Për këtë arsye ai përdor me kaq mjeshtëri një armë të tillë si humori kaq të suksesshme në letërsinë për fëmijë dhe siç e theksuam e aktivizon në gjithë veprën e tij. I. M. Qafëzezi është një autor që priret nga humori dhe sarira dhe duket se ka ditur ta shfrytëzojë atë më mjeshtëri. Për më tepër iu mbetet detyrë studiuesve dhe historianëve të letërsisë të ndërmarin studime më të thelluara lidhur me krijimtarinë letrare të I.

M. Qafëzezit, duke i dhënë vendin që i takon në kulturën dhe letërsinë shqiptare.

## **BIBLIOGRAFIA**

- Aristoteli, Poetika, Tiranë, 2004.
- Bergson H., Lawghter, New York, 1956.
- Bitraku A, I. M. Qafëzezi një thesar ende i pazbuluar i kulturës, 2011.
- Bishqemi A, Historia e letërsisë shpife për fëmijë, Elbasan, 2000.
- Elsie R., Historia e letërsisë shqiptare, Tiran-Pejë, 1997.
- Mato J., Paradokset e satirës dhe humorit, Tiranë, 2000.
- Mato J., Poetika e komikes, Nëntori, nr.7, Tiranë, 1988.
- Meredith G., An essay on comedy, New-York 1956.
- Petrota G., Popolo lingua e letteratura albaneze, Palermo,1931.
- Spaho J., Zhvillimi i komedisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të XX, Buletini Shkencor, Universiteti “F.S. Noli”, Korçë, 2004, nr.8.
- Spaho J., Prurje dhe risi në teatrin korçar të periudhës 1912-39, Buletini shkencor, Universiteti “F. S. Noli”, Korçë, 2010, Nr. 15.
- Qafëzezi,I., Dhaskal Gjoka, Korçë, 1936.
- Uçi A., Estetika e groteskut I, Tiranë, 2001.
- Uçi A., Grotesku në letërsinë shqipe, Tiranë, 2001.
- Velça K. & Zheji Gj., Historia e teatrit shqiptar I, Tiranë, 1984.
- “Historia e letërsisë shqiptare “,Tiranë, 1993.
- “Histori e Shqipërisë”, Tiranë, 1965, f. 282
- “Shkrimtarë shqiptarë” I, II, Tiranë, 1941.